

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Çfarë strategjie mund ta ndjekë Qeveria e Kosovës për apelin në Hagë?
ADRESA	https://piranjat.al/kosova/fare-strategjie-mund-ta-ndjeke-qeveria-e-kosoves-per-apelin-n-e-hage-i106001
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 11:06:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 10:56:19 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	adfef4bd26e103b6b7548a180648bc4e85107d2c9395fae523c6f3da5d10f21f
TEKSTI	3e521c2bcb6f234dfa2efa21c41b676875cf7259665e5783f9467b861699365f
PAMJA	53c57d6eee891c8cec80257e2e3044c639371d8007a8effa58b47faee0d7e0cf

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7b3e5e0dc8769e13a446c8e07ebb251197d15f4576ed1a479f04823f35768f54
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9f67fd8f5341aacd98433415ae2bd1fabd75d8584ec60b7ea3d19ca47caca387
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/7b3e5e0dc8769e13a446c8e07ebb251197d15f4576ed1a479f04823f35768f54

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- EDITORIAL
- EMISIONE
- INVESTIGIME
- AKTUALITET
- SOCIALE
- POLITIKË
- KOSOVA
- BOTA
- SHOWBIZ
- LIFESTYLE
- SPORT

SYRI LIVE



Flash: **pasnekepunetori** janë gjetur 31 bimë të dyshuara ■ **ne Shqipëri** në kohën e bashkuara të Amerikës në Tiranë, Eric Wendy ■ **shqiptaret** paguajnë qivsmën e ngritjen e një strukture të re për barnat dhe ■ **shpenzimet** mujore. A meritoinë publikë me të ardhura më të larta ■ **rritjen më të dobët** në 2021 krahasuar me vitet e kaluara

KOSOVA

Çfarë strategjie mund ta ndjekë Qeveria e Kosovës për apelin në Hagë?

Piranjat Përditësimi i fundit 25 Shtator 2026, 12:56



Tetë ditë nga dënimin me burgim të përgjithshëm prej 81 vjetësh i katër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, protestat kundër vendimit të shkallës së parë dhe thirrjet për një strategji shtetërore në apelin e tij po vazhdojnë të rriten.

Kjo strategji, të cilën Qeveria e Kosovës është zotuar se do ta hartojë, nuk duhet të kufizohet thjesht në **financimin e ekipeve të mbrojtjes**, por duhet përfshijë grumbullimin e ekspertizës vendëse dhe ndërkombëtare, si dhe një angazhim të bashkërenduar diplomatik, vlerësojnë njohës të zhvillimeve politike, me të cilët bisedoi Radio Evropa e Lirë (REL).

Një strategji shtetërore përtej apelit

Qeveria e Albin Kurtit nuk ka shpjeguar se si do të dukej strategjia për ta luftuar në Apelin e asaj që njihet si Gjykata Speciale aktgjykimin dënues për krime lufte ndaj Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit.

Zyra e Kurtit nuk i është përgjigjur pyetjeve të REL-it për më shumë hollësi rreth saj.

Por, duke folur për strategjinë më 19 shtator, Kurti kishte thënë se nevojitet pajtueshmëri për reagim sa më të përshtatshëm dhe efikas ndaj verdiktit, si në ndihmën e ekipeve në instancat e apelit, ashtu edhe në rrafshin diplomatik.

Për Donika Eminin nga Grupi Këshillues për Politikën e Ballkanit në Evropë dhe ish-deputetin e Kuvendit të Kosovës, Ilir Deda, në strategji duhet të përfshihen të gjitha institucionet e vendit, si dhe opozita, ndërsa atë duhet ta shtyjë përpara Ministria e Drejtësisë.

Ky dikaster qeveritar nuk është deklaruar deri tani rreth aktgjykimit, e aq më pak rreth ndonjë strategjie. Udhëheqësja e tij, **Donika Gërvalla**, është në qendër të kritikave, ndërsa shkarkimi i saj është ndër kërkesat e vazhdueshme në protestat e përnatshme në sheshet e kryeqytetit të Kosovës.

Ekspertizë vendëse dhe ndërkombëtare

Përtej rolit të Ministrisë së Drejtësisë, Emiri dhe Deda sugjerojnë se strategjisë do t'i duhej një mekanizëm i qartë koordinues mes institucioneve, ekipeve të mbrojtjes, ekspertëve dhe përfaqësuesve të Kosovës jashtë vendit.

Kjo, sipas tyre, do t'i shmangte veprimet e ndara, dhe do të përcaktonte se kush mbledh dokumentet, kush bashkërendon ekspertizën dhe kush është përgjegjës për komunikimin diplomatik.

Deda këshillon që Kosova të grumbullojë ekspertë të fushave të ndryshme, si juristë ndërkombëtarë, historianë, arkivistë, ekspertë ushtarakë dhe hulumtues të dokumenteve, për t'i ndihmuar mbrojtjes së secilit prej të dënuarve të arrijnë sukses **në apel**.

"Roli i tyre nuk është të rishkruajnë historinë apo të krijojnë fakte të reja, por të ndihmojnë mbrojtjen të gjejë dhe ta kuptojë materialin ekzistues", sipas Dedës.

Ai thotë se prioritet duhet të jenë juristët me përvojë të drejtpërdrejtë në procedurat e apelit para gjykatave penale ndërkombëtare.

“**Apeli** nuk është përsëritje e gjykimit. Ai duhet të identifikojë saktësisht gabimet juridike që e bëjnë aktgjykimin të paqëndrueshëm, gabimet faktike që kanë shkaktuar padrejtësi, si dhe gabimet në përcaktimin e dënimit”, nënvizon Deda.

Kjo, sipas tij, nënkupton se mbështetja shtetërore duhet të përshtatet me nevojat e ekipeve të mbrojtjes, dhe me standardet procedurale të apelit, ndërsa vendimmarrja për argumentet dhe strategjinë juridike mbetet te mbrojtja.

Emini, në anën tjetër, argumenton se, përveç mbështetjes së drejtpërdrejtë të ekipeve të mbrojtjes, ekspertiza ndërkombëtare mund të jetë veçanërisht e rëndësishme për një dimension tjetër: për diplomacinë, për komunikimin ndërkombëtar.

“Për ta vendosur rastin në një kontekst më të gjerë dhe për të pasur diskutime mbi vetë mënyrën se si është trajtuar ky proces, pa e reduktuar çdo diskutim në tensionet politike që ekzistojnë brenda Kosovës”, thotë ajo.

Trupi gjyqës në Hagë e shpalli katërshen e UÇK-së përgjegjëse penalisht për krimet e luftës si ndalimi arbitrar, trajtimi mizor dhe torturimi i qindra njerëzve, dhe për vrasjen e **96 njerëzve**.

Deda thekson se derisa Kosova duhet përmes diplomacisë ta bëjë të qartë se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është përfundimtar dhe se përgjegjësia penale e individëve nuk mund të shndërrohet në faj kolektiv të **UÇK-së**, të luftës çlirimtare apo të vetë shtetit të Kosovës, mbështetja e apelit nuk duhet të shndërrohet në mohim të vuajtjes së viktimave.

“Respekti për viktimat nuk e dobëson mbrojtjen; përkundrazi, ia shton kredibilitetin”, thotë Deda.

Teksa thotë se diplomacia duhet të jetë pjesë e secilësdo strategjie të ardhshme në procesin e apelit, Emini thekson se Qeveria duhet të jetë shumë më e kujdesshme dhe më strategjike në mënyrën se si e bën këtë.

“Diplomacia nuk është thjesht të shkosh në çdo takim dhe të thuash se nuk pajtohesh me aktgjykimin dhe se gjykata ka gabuar”, thotë ajo.

Emini kritikon Qeverinë për mungesë veprimi në këtë fushë, duke thënë se do të duhej të kishte investuar më shumë në krijimin e një diskutimi ndërkombëtar rreth këtij procesi, që nisi me arrestimin e katërshes më 2020.

Qëllimi, sipas saj, nuk do të ishte të bëhej trysni e drejtpërdrejtë mbi **gjykatën**, por që procesi të ndiqej, të studiohej dhe të diskutohej në mënyrë serioze në qarqet juridike, akademike dhe politike. /REL

Artikuj te sugjeruar

KOSOVA 24 Shtator21:13

[Për të nëntën natë, qytetarët protestojnë kundër aktgjykimit të Speciales](#)

Qytetarë të shumtë janë mbledhur sërish të enjten mbrëma në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë...

KOSOVA 24 Shtator21:01

[EMRI/ Shqiptari pranon fajësinë në SHBA për krime kibernetike, drejtoi platformën Rydax](#)

Ardit Kutleshi, 28-vjeçar nga Kosova, është deklaruar fajtor në Shtetet e Bashkuara për akuzat që lidhen me krijimin dhe funksio...

KOSOVA 24 Shtator19:05

[Eurodeputeti kroat: Pa normalizim me Kosovën, Serbia s’ecën drejt BE-së. Merkel fajto](#)

Eurodeputeti kroat nga radhët e partisë HDZ, Davor Ivo Stier, ka deklaruar në emisionin “Romano Bolković – 1 na 1” në televizionin kro...

KOSOVA 24 Shtator18:03

[VIDEO/ Momenti kur pjesëtarët e grupit të Radoiçiqit sulmojnë Policinë e Kosovës me antitank](#)

Në trevjetorin e sulmit të armatosur në Banjskë të Zveçanit, rikthehen në vëmendje pamjet që dokumentojnë mo...

KOSOVA 24 Shtator16:37

[Serbët e Kosovës mes listës së Vuçiçit dhe asaj studentore](#)

Zgjedhjet parlamentare në Serbi, të caktuara për 25 tetor, rikthyen në vëmendje edhe politikën e Beogradit zyrtar ndaj Kosovë...

KOSOVA 24 Shtator13:40

[Nga bllokimi i rrugës me kamionë, tek tërheqja në male, si ndodhi sulmi i Banjskës](#)

Më 24 shtator 2023, në fshatin Banjskë të Zveçanit, në veri të Kosovës, ndodhi përplasja më e rëndë...

KOSOVA 24 Shtator09:53

[Tre vjet nga sulmi në Banjskë, Kurti: Ngadhënjem mbi agresionin e krimin. Terroristët e Beogradit kishin qëllim aneksimin e veriut](#)

Në trevjetorin e sulmit të armatosur në Banjskë, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka kujtuar policin Afrim Bunjaku, i cili u vra ...

KOSOVA 24 Shtator08:15

[Mbi 15 miliardë euro për 18 vjet: Dërgesat e mërgatës në Kosovë arrijnë në 692 mln euro për gjashtë muaj](#)

Remitancat në Kosovë janë rritur me 5.7 për qind në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026, ndërsa gjatë periud...

KOSOVA 23 Shtator21:46

[Nata e tete e protestes “Jo ne emrin tim”, qytetaret mbushin sheshin “Skenderbeu”](#)

Qytetarë të shumtë janë mbledhur sërish sonte në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë, ku po mbahet nata e...

KOSOVA 23 Shtator19:49

[Familjet Thaçi, Veseli e Krasniqi i përgjigjen Haxhiut pas ftesës për takim](#)

Familjet e Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe Jakup Krasniqit kanë publikuar një letër të përbashkët, përmes së cil...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 24 Shtator

[EMRAT/ 63-vjeçari i intubuar te Trauma. Çfarë n...](#)

Një ngjarje e rëndë e ndodhur më 16 shtator në Sarandë, e cila nuk ishte bërë publike më herët, ka përfun...

AKTUALITET 24 Shtator

[Atentati ndaj vëllait të Fabio Dushkut/ Aksioni...](#)

Policia greke ka zhvilluar një aksion në Selanik, ku ka arrestuar tre shtetas shqiptarë të dyshuar për përfshirje në një&eum...

AKTUALITET 24 Shtator

[EMRI/ Ra në gropën e ashensorit dhe vdiq, si u ...](#)

Altin Kokici, një 51-vjeçar me origjinë shqiptare, është gjetur i vdekur natën mes të mërkurës dhe të enjtes...

Nga Xhuljan Ferzaj INVESTIGIME 23 Shtator11:40

[EKSKLUZIVE/ Eskortat e huaja “mbysin” Tiranën: Si vajzat nga Brazili, Kolumbia e Vietnami ofrojnë shërbime sek*uale për 50-150 euro](#)

Prostitucioni me shtetase të huaja po shfaqet gjithnjë e më hapur në disa prej qyteteve kryesore të Shqipërisë. Përmes...

video




PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1



“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.